



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 52/16

Prishtinë, më 06.04.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Adem Grabovci, Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Behxheti- Kryesues i Bordit të RTK-së, Adelina Valla-Menagjere Financiar e RTK-së.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Shefki Kastrati nga NDI, Fjolla Uka-Monitoruese në KDI, Kaltrinë Rexhepi- gazetare në BIRN, Liridona Xhemaj – gazetare e RTK-së Bardhe Shkreli – gazetare në RadioKosova, Norë Shabani –gazetare në Koha Ditore.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 29.03.2016 dhe 30.03.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit tremujor financiar 2016 të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën Prill-Qershor 2016;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 29.03.2016 dhe 30.03.2016**

Kryetari – konstatoi se procesverbalet e datës 29.03.2016 dhe 30.03.2016, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit tremujor financiar 2016 të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën Prill-Qershor 2016

Kryetari - Radiotelevizioni i Kosovës, në pajtim me nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, ka dorëzuar në Kuvend, Raportin tremujor financiar janar-mars 2016 dhe Programin e shpenzimeve të planifikuara për periudhën prill-qershor 2016. Komisioni e ka shqyrtuar Programin e shpenzimeve të RTK-së për periudhën janar-mars 2016, dhe i ka rekomanduar Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të Thesarit për transferin e mjeteve nga Llogari e Fondit të Kosoliduar të Kosovës në xhirollogarinë e RTK-së për periudhën në fjalë. Tani ne duhet të shqyrtojmë raportin tremujor financiar dhe programin e shpenzimeve për tremujorin e dytë, dhe të nxjerrim rekomandimin për Ministrin e Financave për transferin e mjeteve për periudhën prill-qershor 2016.

Ismet Bexheti –ne kemi arritur të bëjmë racionalizimin e shpenzimeve sipas planit të veprimit të miratuar. Racionalizimi ka sjellur efektet e veta edhe në aspektin financiar gjë që tregon edhe raporti tremujor që ka qenë tejet inkurajues, që e ka bërë menaxhmenti. Po për mua është e rëndësishme që të mos sakrifikohet ajo që ne që duhet ta përmbushim ligjërisht, ajo pjesa programore. Por gjithashtu, do të jemi të kujdesshëm që gjatë viti të vazhdohet me këtë trend të shpenzimeve, si tre mujori i parë, por njëkohësisht që të mos e sakrifikojmë pjesën programore dhe përmbushjen e obligimeve ligjore.

Adelina Valla- sqaroi se të hyrat për periudhën janar-mars 2016, kanë qenë 2,950,000 euro. Realizimi i shpenzimeve është 99.93. Të hyrat vetanake janë realizuar për 1,298 euro më pak se ato të planifikuara. Sa i përket shpenzimeve në kategorinë e pagave e medijëve janë realizuar ashtu siç kanë qenë të parapara me projeksionin buxhetor. Për malla dhe shërbime ka pasur një tejkalim për 1%. Për shërbimet publike tekalimet kanë qenë për 11% për shkak se ka pasur disa ngritje të energjisë elektrike. Investimet kapitale janë realizuar mbi 90%. RTK iu është përmbajtur planit të veprimit, që ka pasur për qëllim edhe kursimet prej majit 2015 e deri më tani.

Labinothë Demi-Murtezi - theksoi se nga të dhënat e prezantuara në raportin tremujor, shifet se kemi një ngritje për qeshjet e parapara tek pagat. Por ajo çka më intereson konkretisht është planifikimi prej 40,000 euro për shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, e që janë shfrytëzuar 86% apo 29,966 euro, ndërkajmë medijet e udhëtimit jashtë vendit janë shfrytëzuar komplet 10,000 euro. Pas gjithë këtyre shpenzimeve, pse nuk është transmetuar gara e fundit e Majlinda Kelmendit? Të gjithë qytetarët sukseset e saja është dashur me i kërkuar në internet dhe unë jam ndier shumë keq si deputete, në vizitën që e kemi bërë si deputete të grupit të grave tek Majlinda për me e përgëzue për çmimin, ndërkohë që Televizioni Publik nuk e ka transmetuar shfaqjen!

Sa i përket shpenzimeve për shërbimet e kontraktuara me korrespondentët, janë emisionet si: Jeta në Kosovë, Drejtësia në Kosovë, Betimi në Drejtësi, Supersfida, Pa rrotulla, Ditari i Peshkatarit, dhe këto kanë shumën e përgjithshme të kontraktuara 93,683 euro, ndërsa shpenzimet janë 160,000 euro. Pse janë këto shifra më të larta, kur ju kontrakti paraprakisht këto emisione dhe e dini sa kushtojnë, ndërkajmë kur vjen puna tek shpenzimet, keni tejkalime? Nëse emisioni Betimi në Drejtësi, Drejtësia në Kosovë, Jeta në Kosovë, kërkojnë një staf më të madh, megjithë këtë staf, RTK a nuk e ka një gazetar që e hulumton vet një emision për pashkatarët apo peshkimin, apo të paktën ne si komision me i pas shpenzimet të veçanta për secilin emision dhe jo gjitha këto produkte me një çmim të përbashkët. Apo si është rasti me serialin “The mentelles”, është vendosur çmimi i parë 18,600 euro, ndërsa është paguar 55,200 euro. Nëse kontraktohen të tilla, pse po vjen koha me u pague.

Ismet Bexhet - RTK-ja po përballlet me shumë vështësi që e ka teknologjinë e vjetër. Sa i përket rastit të garës së Majlinda Kelmendi, për shkak të kësaj nuk kemi mundur të transmetojmë ngjarjen. Ne e

kemi obligim që ti promovojmë sportet, por nuk është vetëm rezultat i pakujdesisë por edhe i anës teknike, dhe disa ngjarje i kemi humbur sepse nuk kemi mundësi me i transmetue.

Pas diskutimeve, sqarimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se komisioni me Gjashtë vota Për, Një Abstenim dh Asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni përkahu Raportin tremujor të shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-mars 2016 dhe i rekomadohet Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 Prill – 30 Qershor 2016, në shumën prej 2,400,000 (dy milion e katërqind mijë) Euro.

4. Të ndryshme

Kryetari – theksoi se në konsultim me Kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Qeverise Lokale dhe Media, është vlerësuar e rëndësishme dhe e nevojshme që të krijohet në grup punues i përbashkët në mes dy komisioneve, për të punuar rreth gjetjes së mënyrës së financimit afatgjatë të RTK-së, përmes amendamenteve në Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës. Unë propozojë që nga Komisioni ynë, anëtarë të grupit të përbashkët punues, të caktohen: Bardhyl Meta, Safete Hadergjonaj dhe Fikrim Damka. Këta anëtar bashkpunojnë me grupin punues të Komisionit funksional dhe informojnë komisionin për punën e bërë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:34

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani